



Organizata Për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias

## KONFERENCA E PARË E OSBE-SË PËR MEDIAT NË EVROPËN JUGLINDORE

### DEKLARATË

#### “Përkitazi me rrugëtimin drejt lirisë së mediave”

*Më 13 dhe 14 tetor 2011 është mbajtur Konferenca e parë e OSBE-së për Mediat në Evropën Juglindore, në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë e organizuar nga Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë dhe me ndihmën e Pranisë së OSBE-së në Shqipëri, Misionin e OSBE-së në Kosovë, Misionin e OSBE-së në Mal të Zi, Misionin e OSBE-së në Serbi, dhe Misionin e OSBE-së në Shkup.*

*Afërsisht 100 ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë dhe përfaqësues të mediave nga Evropa Juglindore morën pjesë në konferencë për të diskutuar zhvillimet e fundit rreth mediave dhe sfidat në rajon.*

*Konferenca në mënyrë specifike u përqendrua në pavarësinë e medias: përfshirë këtu çështjet e shërbimit të transmetimit publik, sfidat ligjore për lirinë e medias, dhuna ndaj gazetarëve dhe frikësimi i tyre si dhe kushtet e tyre të punës.*

#### ***Pjesëmarrësit në konferencë***

*Duke e theksuar lirinë e shprehjes si e drejtë themelore dhe shtyllë kryesore e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit;*

*Duke e rikonfirmuar rëndësinë themelore të lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias – përfshirë këtu edhe parimet e pavarësisë, pluralizmit dhe diversitetit – si të drejta në vete por edhe si vegla për mbrojtjen e të drejtave tjera, si element kyç i demokracisë, dhe i avancimit të synimeve për zhvillim;*

*Duke nënvizuar që vetëm mediat që janë me të vërtetë të pavarura në aspektin politik, redaktorial dhe ekonomik mund ta përmbushin rolin e tyre kyç në një shoqëri demokratike: për të qenë vëzhgues të qeverive dhe bizneseve që e njoftojnë audiencën e tyre lidhur me të gjitha aspektet e rëndësishme të jetës në mënyrë të pavarur, duke reflektuar një sërë pikëpamjesh, duke i lejuar shoqëritë që të marrin vendime të informuara gjatë zgjedhjes apo vlerësimit të qeverive të tyre;*

*Duke e njohur faktin që mediat në pronësi të shtetit nuk duhet të ekzistojnë në një shoqëri demokratike;*

Duke e *vërejtur* përparimin thelbësor që është arritur në Evropën Jug-lindore që nga kalimi i saj në demokraci në vitet e 90-ta në reformimin e ligjeve dhe politikave të vjetruara dhe represive të mediave;

Duke e *pranuar* që zbatimi i legjislacionit për media liberale mbetet problematik dhe që kërkohet reformim i mëtutjeshëm i legjislacionit për media në fushën e shpifjes në kontekstin penal dhe civil, transmetimit publik, licencimit të transmetuesve, qasjes në informata, transparencës lidhur me pronësinë e mediave dhe mbrojtjen e të drejtave të punës së gazetarëve;

Të *bregosur* për numrin domethënës të sulmeve të dhunshme kundër gazetarëve dhe kundër pronës që i përket mediave, si dhe për numrin edhe më të madh të rasteve ku gazetarët dhe pjesëtarët e familjeve të tyre janë frikësuar;

Duke e *mirëpritur* dënimin e sulmeve të tilla dhe suksesin në rritje e sipër në hetimin e rasteve të dhunës kundër gazetarëve dhe sjelljen e kryerësve të tyre para drejtësisë;

Duke *Theksuar* që qeveritë duhet megjithatë të shtojnë edhe më tutje masat për reagim ndaj sulmeve të dhunshme dhe frikësimit të gazetarëve si dhe pjesëtarëve tjerë të mediave dhe të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi miqësor për mediat në të cilin gazetarët dhe redaktorët respektohen dhe konsiderohen si agjent të domosdoshëm të publikut;

Duke *njohur* nevojën për zhvillim dhe mirëmbajtje të mekanizmave vetë-rregullues të cënueshëm të mediave që janë të pavarura nga autoritetet, në bazë të standardeve më të larta të sjelljes profesionale, përmirësimin e cilësisë së gazetarisë dhe të ofrimit të një reagimi adekuat dhe proporcional ndaj gabimeve të gazetarëve dhe shkeljes së etikës së mediave;

Duke qenë të *vetëdijshëm* për sfidat që dalin nga kushtet e këqija të punës së një pjese të madhe të gazetarëve që punojnë në Evropën Juglindore, përfshirë këtu ekzistimin e marrëveshjeve joformale të punësimit të cilat nuk e lejojnë stabilitetin e tyre ekonomik dhe përfitimet sociale;

***Miratojnë*** këtë deklaratë:

### ***1. Pavarësia e medias***

- Ekziston një nevojë urgjente për përforsim të mëtutjeshëm të pavarësisë së medias dhe të organeve të tyre rregulluese autonome;
- Autoritetet publike në të gjitha nivelet duhet në mënyrë të pavarur dhe të vendosur të njohin dhe sigurojnë pavarësinë e transmetuesve të tyre përkatës publik, si atë editoriale ashtu edhe financiare, pasi që është e një rëndësie vendimtare për të siguruar funksionim të mirë të demokracisë dhe shërben si shtyllë kryesore për lirinë e medias;
- Media nuk duhet të jetë në pronësi të shtetit. Disa korniza ligjore për media ende nuk i ndalojnë institucionet dhe zyrtarët publik nga mbajtja në pronësi e një mediumi. Në të njëjtën kohë, në vendet ku një pronësi e tillë është e ndaluar një gjë e tillë mund të anashkalohe duke e maskuar kështu një konflikt të mundshëm të interesit;

- Hisedarët e shoqërisë civile, mediave dhe qeverisë, duhet të promovojnë dhe zbatojnë standarde dhe parime të përbashkëta të pavarësisë së medias;

## ***2. Reformimi i legjislacionit për media***

- Miratimi i legjislacionit për media duhet të paraprihet nga diskutime të gjëra dhe përfshirëse publike dhe parlamentare;
- Çdo legjislacion për media duhet të jetë në pajtim me zotimet e OSBE-së për lirinë e medias dhe standardet ndërkombëtare, si dokumentet e Këshillit të Evropës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Qeveritë duhet të bëjnë përpjekje që të mbështesin punën e autoriteteve të pavarura rregulluese;
- Parlamentet duhet të krijojnë mekanizma monitorues për të siguruar, implementim të duhur, uniform dhe të plotë të legjislacionit për mediat, jashtë çdo ndikimi politik dhe ekonomik.

## ***3. Përforcimi i mediave publike***

- Legjislacioni ekzistues për shërbimin e transmetimit publik duhet të zbatohet plotësisht për të garantuar pavarësi editoriale dhe financiare të transmetuesve publik;
- Pavarësia financiare e shërbimit të transmetimit publik duhet të garantohet me ligj;
- Autoritetet publike duhet të zhvillojnë dhe implementojnë mekanizma adekuat të financimit që mundësojnë një punë të qëndrueshme të shërbimit të transmetimit publik, duke siguruar kështu planifikim efikas afatmesëm dhe afatgjatë nga ana e tyre.
- Shërbimi i transmetimit publik duhet të bëjë përpjekje që të zhvillojë program cilësor për të gjitha segmentet e audiencës së tij, përfshirë pakicat kombëtare, në bazë të parimeve të balancimit dhe paanshmërisë.

## ***4. Ndalimi i dhunës dhe frikësimit të gazetarëve***

- Të gjitha rastet e kërcënimeve dhe dhunës kundër gazetarëve duhet të hetohen në baza ditore me kohë dhe në mënyrë proaktive. Kryerësit dhe organizatorët e këtyre veprave duhet të sillen pranë drejtësisë në gjykime të hapura për publikun dhe mediat.

## ***5. Reformimi i ligjit për shpifje***

- Shpifja duhet të de-penalizohet plotësisht; ankesat për shpifje duhet të trajtohen ekskluzivisht nga gjykatat civile;
- Dëmshpërblimet civile duhet të jenë proporcionale me dëmin e shkaktuar dhe në asnjë rast nuk duhet të shpijnë në falimentim të mediave e kjo me qëllim të eliminimit të efektit të “ftohjes” nga gazetaria kritike. Kjo mund të arrihet përmes vendosjes së një kufiri në dëmshpërblimet materiale në rastet civile;
- Ligjet duhet gjithashtu të kërkojnë nga zyrtarët publik që të demonstrojnë një shkallë më të madhe të tolerancës ndaj kritikave nga mediat, edhe në rastet kur raportet për çështjet publike përmbajnë pasaktësi faktike.

## ***6. Promovimi i vetë-rregullimit vullnetar dhe të pavarur dhe gazetaria etike***

- Mekanizmat e vetërregullimit të medias, përfshirë kodet e etikës të hartuara dhe miratuara nga vetë gazetarët, pa kurrfarë ndërhyrje nga autoritetet publike, përmirësojnë cilësinë e gazetarisë dhe e ruajnë lirinë e medias;
- Gazetarët profesionist duhet të bëjnë përpjekje që të jenë të saktë dhe objektiv, dhe të respektojnë kodet e etikës, pasi që mekanizmat transparent vetë-rregullues ofrojnë mjete të mjaftueshme juridike për personat reputacioni i të cilëve është dëmtuar dhe kontribuojnë në rritjen e profesionalizmit dhe besueshmërisë së mediave.

## ***7. Sigurimi i transparencës lidhur me pronësinë e mediave***

- Kufizimi ndaj koncentrimin të mediave dhe pronësia transparente e mediave janë parakushte për pluralizëm në media;
- Anashkalimi i Ligjit për pronësinë e mediave dhe konkurrencën, nga grupe të kompanive të cilat vetëm duken të jenë të pavarura nga njëra tjetra por në fakt janë pronë e një subjekti, duhet të ndalet;
- Rregullat për konflikt të interesit, si dhe ligjet për liri të informimit, duhet të zbatohen si duhet pasi që ato ndihmojnë në rritjen e transparencës lidhur me pronësinë;
- Parlamentet, në kuadër të obligimit që e kanë për ruajtjen proaktive të pluralizmit të mediave, duhet të miratojnë ligje që e kufizojnë pronësinë e tërthortë të mediave të transmetuara dhe shkruara;
- Qeveritë duhet të njohin dhe ndalojnë ndikimin që agjencitë e reklamave e kanë mbi media. Të hyrat nga reklamimi nuk duhet të përdoren si mjet i presionit ekonomik nga korporatat dhe qeveritë;
- Qeveritë dhe partitë politike duhet të sigurojnë transparencë në ndarjen e reklamave të financuara nga fondet publike.

## ***8. Nevoja për përforcimin e sindikatave të gazetarëve dhe përmirësimin e kushteve të punës së gazetarëve***

- Garancitë ligjore për respektimin e të drejtave themelore të punësimit për gazetarët duhet të forcohen. Gazetarët duhet të jenë në gjendje që të përdorin mjete efektive juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre të punës;
- Organizatat e gazetarisë, organet vetërregulluese dhe OJQ-të duhet të rrisin bashkëpunimin e tyre duke i ndarë dhe promovuar praktikat më të mira;
- Gazetarët duhet ta bazojnë punën e tyre në standardet profesionale dhe të angazhohen më fuqishëm në krijimin e solidaritetit të vërtetë profesional ndërmjet tyre, duke i qëndruar presionit nga punëdhënësit dhe korporatat e mediave që favorizojnë raportim të njëanshëm dhe të politizuar.